





MOTIVACIONI


Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ka provuar të jetë një instrument thelbësor në zhvillimin dhe finalizimin e aplikimeve të dobisë publike për shkak të aftësive të saj për të trajtuar skenare komplekse, si dhe në integrimin e komponentëve jo-homogjenë. Në këtë aspekt të rreziqeve hidro-meteorologjike, siç janë shpërthimet konvektive që prekin fushat e Adriatikut përfaqësojnë një kërcënim serioz i cili duhet të përballet me përdorimin e të dhënave të fuqishme matëse dhe përpunimin e infrastrukturave të TIK.



TESTI I FUSHAVE TË ADRIATIKUT

Dy zona pilot (Rajonet Marche/Abruzzo dhe territoret e Kroacisë/Shqipërisë) janë identifikuar si zona provë për të integruar sistemin e ADRIARadNet në mbështetje të procedurave dhe vendimeve në ndihmë të Mbrojtjes Civile.

Në këto zona janë parashikuar të instalohen **radarë me kosto të ulët**, të cilët do të integrohen me rrjetet ekzistuese të sensorëve të reshjeve në mënyrë që të shfrytëzohen për arritjen e objektivave që synon ADRIARadNet.



OBJEKTIVAT

Objektivat e ADRIARadNet kanë të bëjnë me **ngritjen dhe integrimin e një infrastrukture TIK të bazuar në web**, të shkallëzuar-fleksibël dhe të ndërveprueshme, të bazuar në një rrjet **radarësh për motin me kosto të ulët**, që së bashku me **të dhënat satelitore** të cilat do të integrohen me sistemet informative gjeografike dixhitale, me modelet numerike të parashikimit të përshtatur për rajonin si dhe me sistemet e parashikimit dhe parandalimit, të gjitha këto në mbështetje të vendimmarrjes së Mbrojtjes Civile për rajonin Qëndror dhe Jugor të Adriatikut. Në përmbledhje projekti ADRIARadNet synon mbulimin e “miljes së fundit” mes botës hidrometeorologjike dhe qeverisjes rajonale përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen e popullsisë civile.

